



RAPORTI VJETOR

2020

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Shkurt, 2021

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

- Organi Shqyrtues i Prokurimit gjatë vitit 2020 ka bërë ndryshimin dhe plotësimin e Rregullorës së Punës, e cila tanimë është e publikuar në uebfaqe të Organit Shqyrtues të Prokurimit ku konfom ligjit dhe në bazë të të cilës po zhvillohet puna e OSHP-së.
- Edhe gjatë vitit 2020, Organi Shqyrtues i Prokurimit ishte ballafaquar me probleme në anëtarësinë e plotë të bordit, i cili njëherit luan rolin e panelit shqyrtues për shqyrtimin e ankesave të parashtruara nga operatorët ekonomikë lidhur me aktivitetet e tenderimit. Bordi i OSHP-së edhe gjatë këtij viti ka zhvilluar punën në mungesë të dy anëtarëve.
- Organi Shqyrtues i Prokurimit gjatë vitit 2020 ka bërë publikimin e të gjitha aktivitetëve të prokurimit të cilat janë shqyrtuar përmes ankesave. Kjo ishte arritur përmes lansimit të uebfaqes së re zyrtare, ku ndër të tjerash, në uebfaqe transmetohen drejtëpërsëdrejti seancat dëgjimore të mbajtuara në Organin Shqyrtues të Prokurimit.
- Gjatë vitit 2020, Organi Shqyrtues i Prokurimit gjithsej i ka shqyrtuar **1184** ankesa të parashtruar nga operatorët ekonomikë kundrejt vendimeve të autoriteteve kontraktuese lidhur me aktivitetet tenderuese.

BAZA LIGJORE

- **Baza ligjore ekzistuese**

- Organi Shqyrtues i Prokurimit veprimtarinë e ushtron konform Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-237 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Ligjin Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe Ligjin Nr. 05/L-092 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 dhe me Ligjin Nr. 05/L-068, Rregulloren Nr. 01/2020 e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, si dhe legjislacionin dytësor të prokurimit publik të hartuar nga Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik.
- **Vështirësitë ligjore që i ka hasur Organi Shqyrtues i Prokurimit në përmbushjen e misionit të tij**
- Mungesa e përzgjedhjes së anëtarëve të bordit ka shkaktuar mbingarkesë në punën e OSHP-së, por duke pasur parasysh numrin e ankesave të pranuar dhe atyre të përfunduara deri në fund të vitit, mund të themi se situata po menaxhohet mirë nga anëtarët aktual të Bordit të OSHP-së.

Gjatë vitit 2020 Organi Shqyrtues i Prokurimit është ballafaquar në punën me pandeminë Covid 19, ashtu siç janë ballafaquar të gjitha institucionet publike dhe ndërkombëtare. Mungesa e dy anëtarëve të Bordit dhe puna gjatë pandeimisë kanë qenë një vështirësi e madhe për Organin Shqyrtues të Prokurimit.

- Organi Shqyrtues i Prokurimit, ndër vite ka potencuar numrin e vogël të stafit të brendshëm, veçanërisht të ekspertëve shqyrtues, duke u detyruar kështu që të angazhojë një numër të madh të ekspertëve të jashtëm për të shqyrtuar ankesat e pranuar, e që në vitin 2020 kanë qenë në rritje. Për këtë arsye, OSHP konsideron se është i domosdoshëm që buxheti i caktuar për OSHP-në si

organizatë buxhetore të rritet në mënyrë që plotësohen nevojat për angazhim të ekspertëve të jashtëm shqyrtues profesional e teknik, të rritet numri i trajnimëve të stafit aktual dhe atyre që pranohen në punë rishtas, dhe të aprovohen poashtu pozita shtesë në porporcion me numrin e ankesave të pranuar.

- **Përmisimi i bazës ligjore**

- Organi Shqyrtues i Prokurimit në fund të vitit 2019 kishte inicuar ndryshim/plotësimin e rregullores së brendshme të punës, me ç’rast rekomandimet e z. Steen Bruun-Nielsen- ekspert I angazhuar nga projekti TIM për OSHP-pë janë evidentuar dhe modelet e sygjera për akt-ekspertizë dhe vendim të paneleve shqyrtuese, janë përfshirë si akte të brendshme të Oranit Shqyrtues të Prokurimit. Rregullorja e inicuar gjatë vitit 2019 në fillim të vitit 2020 janë finalizuar. Organi Shqyrtues i Prokurimit, gjatë vitit 2020 ka punuar me rregulloren e re të punës e cila natyrisht ka ndikuar për punë sa më cilësore të stafit dhe ekspertëve shqyrtues.
- Poashtu, Organi Shqyrtues i Prokurimit, është pjesë e grupit punues për ndryshime ligjore të cilët po planifikohen të bëhen në sferën e prokurimit publik të inicuar në janar të vitit 2019 nga Minisistria e Financave. Grupi Punues i themeluar nga të gjitha insitucionet gjegjëse prej 23 anëtarësh, janë duke punuar në Draft Ligjin e Ri për Prokurim Publik.
- Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, ka anëtarin e saj pjesë të grupit përmes të cilit po punon në pjesën për OSHP-në gjithmonë duke pasur para sysh rëndësinë që ka OSHP-ja për forcimin e tërësishëm të sistemit të prokurimit publik të Kosovës, si dhe trajtimin ligjor të ankesave në mënyrë profesionale dhe në baza ligjore.

PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

- **Misioni/Vizioni i Organit Shqyrtues të Prokurimit**
- Organi Shqyrtues i Prokurimit konform Planit Strategjik të OSHP-së për vitet 2018-2020, si vizion primar ka karakterizimin si një institucion kredibil, efikas dhe efektiv në çështjet e prokurimit publik, si dhe shqyrtimi i ankesave në

mënyrë të drejtë dhe të paanshme, duke i pasur parasysh praktikat më të mira të Bashkimit Evropian dhe legjislacionit të tij lidhur me prokurimin publik, dhe ofrimin e mbrojtjes ndaj operatorëve ekonomikë vendorë, dhe të huaj lidhur me shkeljet eventuale të bëra nga autoritetet kontraktuese.

- Në përputhje me vizionin primar, Organi Shqyrtues i Prokurimit promovon dhe ngritjen e transparencës, mundësimin në qasje në dokumente publike, dhe rritjen e kapaciteteve profesionale, si dhe bashkëpunimi me akterët relevantë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.
- Për të arritur synimet e parapara me aktet e brendeshme, Organi Shqyrtues i Prokurimit, bën transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave dëgjimore që mbahen me operatorët ekonomik dhe autoritetet kontraktuese, dhe të gjitha palëve të interesit. Me paraqitjen drejtpërdrejtë të seancave dëgjimore në ueb sajt, OSHP po arrin atë që gjithmonë ka pasur qëllim të arrij, transparencën në raport me palët e interesit dhe popullatën në tërësi. Rritja e transparencës ndaj operatorëve ekonomik nëpërmjet avancimit të ueb faqes për qasje dhe informata sa më të shpejta për palët e interesuara, është një ndër synimet kyqe për OSHP-në.
- Duke qenë se e gjithë bota është ballafaquar me situatën me pandemi dhe grumbullimi i shumë personave në një ambient të mbyllur është i rrezikshëm, OSHP gjatë kësaj kohe po mban seancat dëgjimore përmes platformës online me të gjitha palët në procedurë.
- Gjatë vitit 2020 OSHP, ka përfituar nga projekti i Ambasadës Britanike në Prishtinë: “Forcimi i Sistemit të Prokurimit Publik në Kosovë” dhe i cili projekt ka filluar në fund të muajit tetor dhe do ta mbështet OSHP në 3 vitet e ardhëshme, për të ndihmuar me konsulence profesionale në sistemin sa më të drejtë dhe të arsyeshëm të OSHP-se, dhe trajtimin ligjor të ankesave në Draft Ligjin e Ri për Prokurim Publik.

- Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Komisionin Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP). Qëllimi i kësaj marrëveshje është përcaktimi i parimeve të përgjithshme të bashkëpunimit në fushën e prokurimit publik, për të shtyer përpara përpjekjet e përbashkëta për një proces efikas, efektiv dhe transparent në fushën e prokurimit publik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik, si dy institucione përgjegjëse, të rëndësishme në fushën e prokurimit publik, me anë të kësaj marrëveshje janë siguruar për shkëmbimin e informatave, mbajtjen e takimeve të rregullta të përbashkëta për adresimin e çështjeve specifike të prokurimit, të sigurohen për bashkërendimin e veprimeve si dhe hartimin e politikave me qëllim të përmisimit të praktikave sa më të mira të prokurimit.

- **Faqja e Internetit**

- Organi Shqyrtues i Prokurimit, me qëllim të rritjes së transparencës përballë të gjitha palëve të involvuara në aktivitete të prokurimit, dhe transparencës karshi qytetarit të Kosovës, ka uebfaqen zyrtare “<https://oshp.rks-gov.net>”, ku bën publikimin e pretendimeve ankimore të operatorëve ekonomik, të cilët pretendojnë se ju janë shkelur nga autoritetet kontraktuese, raportet e ekspertizave dhe vendimet e panelit shqyrtues për çdo lëndë. Po ashtu, ëeb-faqja përmban versionet elektronike, të të gjitha vendimeve të Paneleve Shqyrtuese, konkluzioneve, urdhëresave, njoftimeve, ekspertizave, raporteve dhe informatave tjera të rëndësishme lidhur me aktivitetet e OSHP-së, si dhe bënë transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave dëgjimore për shqyrtimin kryesor të ankesave.

Në kanalin tonë Zyrtar në Youtube mund të gjinden të gjitha videoseancat e mbajtura nga viti 2020.

Gjithashtu ëeb faqja e Organit Shqyrtues vizitohet nga vendet e rajonit po edhe pothuajse nga të gjitha vendet e botës, kjo ëeb faqe përmban verzionin e gjuhës Serbe si dhe Angleze

- **Kompetencat e Organit Shqyrtues të Prokurimit sipas ligjit të prokurimit publik**
- Organi Shqyrtues i Prokurimit disponon një mori kompetencash, të specifikuara në pjesën IX, nenin 105 të ligjit të prokurimit publik nr. 04/L-042, të cilat kompetenca saktësohen si në vijim:
 - Të shqyrtojë ankesat nga palët me interes lidhur me shkeljet e pretenduara nga ligji i prokurimit publik;
 - Të jap urdhëra ndaj çdo personi, ndërmarrje ose autoriteti publik duke kërkuar që një person, ndërmarrje ose autoritet publik të dorëzojë, bartë, paraqesë dhe/ose mundësojë qasje në të dhëna, informacione, dokumente, dhe/ose artikuj të tjerë të pasurisë së luajtshme dhe/ose të paluajtshme që paneli shqyrtues i konsideron relevante për vendosje në çështjen e prokurimit;
 - Të jap urdhëra ndaj çdo personi për t`u paraqitur në procedurën për shqyrtimin e prokurimit dhe të jap dëshmi lidhur me çdo çështje që paneli shqyrtues e konsideron relevante për vendosje në çështjen e prokurimit;
 - Të jap urdhër me të cilën menjanjohet ose pezullohet dhënia e kontratës publike, nëse kontrata publike nuk është nënshkruar ende nga palët kontraktuese;
 - Ta urdhëroj autoritetin kontraktues që ta suspendojë ose përfundojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit, ose ta urdhëroj autoritetin kontraktues zbatimin e vendimit të autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit;
 - Ta urdhëroj autoritetin kontraktues që ta kompensojë parashtruesin e ankesës;

- Ta urdhëroj autoritetin kontraktues që të korrigjojë shkeljen e pretenduar dhe/ose të parandalojë dëmtimin e mëtejshëm të parashtruesit të ankesës dhe/ose të ndonjë palë tjetër me interes;
- Ta urdhëroj autoritetin kontraktues që t'i menjanojnë specifikimet diskriminuese teknike, ekonomike dhe/ose financiare të përzgjedhjes, kërkesat dhe/ose kriteret e përfshira në njoftim, ftesë, dosjen e tenderit dhe/ose dokumentet e tjera të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit;
- Të lëshoj urdhëra me të cilin detyrohen zyrtarët të bëjnë zbatimin e një vendimi dhe/ose urdhëri të OSHP-së;
- Të lëshoj urdhëra për ta shëndrruar një kontratë publike të lidhur si jo-efektive, nëse janë plotësuar rrethanat të përcaktuara me ligj të prokurimit publik;
- Të imponoj gjopa ndaj autoritetit kontraktues, nëse ky i fundit vazhdon implementimin e kontratës përkundër faktit se OSHP e ka shpallur kontratën publike pa efekt juridik; dhe
- Kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj të prokurimit publik dhe ligje përkatëse.

ORGANIZIMI INSTITUCIONAL

- **Organizimi, veprimtaria, personeli dhe niveli i rrogave**
- Organi Shqyrtues i Prokurimit konform Ligjit Nr. 05/L-092 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 dhe me Ligjin Nr. 05/L-068,

përfaqësohet nga Kryetari, i cili është përgjegjës për menaxhimin dhe organizimin e punës të Organit Shqyrtues të Prokurimit, si dhe përgjegjës për administrimin e përditshëm të veprimtarisë së Organit Shqyrtues të Prokurimit. Për ndonjë fushë specifike, Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit mund të delegojë funksionet dhe përgjegjësitë e tij tek ndonjë anëtar tjetër i Organit Shqyrtues të Prokurimit. Në mungesë të Kryetarit, kompetencat dhe funksionet e Kryetarit ushtrohen nga anëtari më i vjetër i Organit Shqyrtues të Prokurimit.

- Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit njëherit është anëtar i bordit. Bordi mbështetet nga sekretariati, i cili udhëhiqet nga Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për menaxhimin e punëve ditore.
- Në kuadër të sekretariatit, konform rregullores të Organit Shqyrtues të Prokurimit, funksionon Divizioni i Brendshëm, Divizioni për Shqyrtimin e Ankesave, dhe Njësia Ligjore.

- **Bordi**

- Përbërja e anëtarëve të bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit është pesë (5), mirëpo, prej datës 07 korrik 2017, me anë të vendimit P.Sh. Nr. 494/17 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, konform nenit 101 të Ligjit për prokurim publik nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092 dy (2) anëtarë të bordit janë suspenduar meqë Kuvendi i Kosovës ka njoftuar Kryetarin e Organit Shqyrtues të Prokurimit se në Gjykatën Themelore në Prishtinë, iu ishte ngritur aktakuza. Që nga 06 korrik 2017, OSHP punon vetëm me tre anëtar Bordi e që dy ish anëtarëve tani më ju ka skaduar edhe mandati. Në fillim të vitit 2019, Qeveria e Kosovës ka shpallur konkursin për plotësimin e dy vendeve të lira në Bord, dhe në fund të vitit 2020, ka dërguar në Kuvend listën e kandidatëve që kanë plotësuar kushtet e konkursit, mirëpo për shkak të ndryshimeve politike dhe shpërbërjes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, propozimet nuk janë rishikuar nga Kuvendi.
- Mandati i Kryetarit dhe anëtarëve të bordit është pesë (5) vjeçar. Mandati i Kryetarit dhe dy anëtarëve aktual ju skadon me datë 30 mars 2021. Me skadimin e mandatit të anëtarëve aktual, OSHP do të mbetet pa bord.

- Bordi i Organit Shqyrtues të Prokurimit është organ vendimarrës sa i përket shqyrtimit të ankesave të parashtruar nga operatorët ekonomikë. Punën e tyre e zhvillojnë përmes paneleve shqyrtuese, ku me ç'rast përmes seancave, qoftë dëgjimore apo të mbyllura, vendosin mbi themelësinë e ankesave të operatorëve ekonomik.
- **Sekretariati**
 - Sekretariati udhëhiqet nga Kryesuesi i Sekretariatit, organ i cili është përgjegjës që t'i ofroj mbështetje administrative bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, të bëjë menaxhimin e punëve ditore, dhe të zhvilloj politikat e rekrutimit për shërbyes civil dhe angazhimin e ekspertëve të jashtëm profesional dhe teknikë, varësisht nga nevojat e institucionit, së bashku me Kryetarin e OSHP-së.
- **Burimet Njerëzore**
 - Organi Shqyrtues i Prokurimit ka Zyrën për Burime Njerëzore, si njësi e veçantë në kuadër të Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të punës, dhe politikave të punësimit sa i përket të punësuarve në Organ Shqyrtues të Prokurimit.
- **Numri i punëtorëve**
 - Për vitin 2020, Organi Shqyrtues të Prokurimit e ka mbyllur vitin me udhëheqësin e zyrës për pranimin të ankesave, udhëheqësin e departamentit të brendëshëm, tre (3) Zyrtarë të Lartë Ligjorë, një (1) Zyrtar për të Hyra, një (1) Zyrtar për Pranimin e Ankesave; një (1) Zyrtar për Teknologji Informative; një (1) Zyrtar për Arkivë; një (1) Zyrtar Kryesor për Financa, një (1) Zyrtar i Lartë Gjuhësore; një (1) Menaxhere e Personelit; nëntë (9) Ekspert Shqyrtues.
- **Nevojat për punëtorët të rinjë**
 - Organi Shqyrtues i Prokurimit ka identifikuar nevoja për punëtorë të rinjë e andaj gjatë vitit 2020 ka rekrutuar tre (3) ekspertë shqyrtues dhe dy (2) zyrtarë të lartë ligjorë, ndërsa gjatë vitit që vjen është në përgaditje të procedurave për të rekrutuar ekspert shqyrtues dhe një asistent/e administrativë.

- Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka poashtu nevojë për staf shtesë në mënyrë që të zvogëloj angazhimin e eskeprteve të jashtëm, që marrin një pjesë të konsiderueshme të buxhetit të OSHP-së.

- **Numri i trajnimeve dhe nevojat për trajnim**

- Gjatë vitit 2020, OSHP përmes të autorizuarëve të saj, Sekretarin e OSHP-së, Udhëheqësin e departamentit për shqyrtim të ankesave, udhëheqësin e njësisë së brendeshme, zyrtares për burime njerëzore, tre (3) eksperteve shqyrtues, zyrtares për të hyra, zyrtares për pranim të ankesave, zyrtares për përkthime, zyrtarit për IT ka ndjekur Trajnimin e Avancuar për Prokurimi Publik të organizuar nga Instituti i Kosovës për trajnime- IKAP.

Gjithashtu janë certifikuar në Trajnimin Themelor Profesional për Prokurim edhe dy (2) ekspertë shqyrtues të pranuar në punë gjatë vitit 2020 dhe dy (2) zyrtarë të lartë ligjor të cilët poashtu janë pranuar në punë gjatë vitit 2019.


- Vlen të potencohet fakti se OSHP ka nevojë për trajnim të stafit në fusha të ndryshme që ndërlidhen me prokurimin publik, e që mund të thuhet se gjatë 2020-tës këto trajnime kanë qenë të pakta për shkak të buxhetit të limituar, e që për këtë edhe është paraparë nevoja për rritjen e buxhetit të dedikuar për vitin fiskal.

- **Puna gjatë vitit 2020**

- Paneli shqyrtues gjatë vitit 2020 ka shqyrtuar **1184** ankesa gjithesej. Paneli shqyrtues ka aprovuar vendimet e Autoriteteve Kontraktuese, si të bazuara në **339** raste, duke konstatuar se pretendimet e palëve ankimore nuk kanë qenë të mbështetura në argumente ligjore që të aprovohen ankesat e tyre; Paneli Shqyrtues ka marrë vendim për rivlerësimin e ofertave në **605** raste, duke konstatuar se është bërë vlerësimi i gabuar i ofertave nga komisionet vlerësuese, duke hasur në shkeljet e caktuara të LPP-së dhe rregullave të prokurimit publik; Paneli Shqyrtues ka marrë vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit (Ritenderim) në **63** raste, nisur nga shkeljet e konstatuara të dispozitave të LPP-së, për parregullsitë në dosjet e tenderit, vlerësim jo të drejtë të ofertave apo për zhvillimin me mangësi të procedurave të prokurimit; **80** ankesa janë hedhur poshtë për shkak të mos-kompletimit të tyre brenda afatit ligjor në pajtim me nenet 111.4 dhe 118.1 të LPP-së; Para se të merren në shqyrtim nga Paneli

Shqyrtues, **25** ankesa të dorëzuara, janë tërhequr nga operatorët ekonomik ankues; Paneli shqyrtues gjatë vitit 2020, ka lëshuar gjithsejtë **17** urdhëresa, Shtyrje e afatit për ofertim **10** raste dhe Ndryshim në dosje të tenderit **45** raste.

- Operatorët Ekonomik me rastin e paraqitjeve të ankesave konform nenit 118 të LPP-së, dhe Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave konform nenit 14 kanë qenë të obliguar të deponojnë sigurimin e ankesave një përqind (1%) te vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.
- Në formë grafike janë të paraqitura numri dhe përqindja e ankesave të pranuar dhe të shqyrtuara nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për vitin 2020.



Nr	Autoriteti Kontartkues	Ankesa të pranuar a	Aprov. i vend. të AK-së	Ri vlerësim	Ri tenderim	Tërheqje e e Anke.	Flakje e Ankesës	Urdhër për Zbatim të vend. PSH-së	Ndryshim në Dosje të Tenderit	Përmirësim- Zgajtje e afatit për ofertim
1	Zyra e Kryeministrit	1		1						
2	Kuvendi i RKS	1	1							
3	Ministria e Shëndetësisë	28	6	9	7		6			
4	Ministria e Mbrojtjes	14	6	7			1			
5	MBPZHR	4		3		1				
6	MKRS	12	5	5	1		1			
7	Ministria e Infrastrukturës	31	9	18			3			1
8	Ministria e Punëve të Brendshme	16	2	7	1		3		3	
9	Minsitria e Administratës Publike	8	3	5						
10	Ministria e Arsimit	20	5	10		1	4			
11	Ministria e Financave	2		1	1					
12	MTI	4		1	2		1			
13	Telekomi i Kosoves	3	2	1						
14	MZHR	1		1						
15	MMPH	14	7	7						

Nr	Autoriteti Kontartkues	Ankesa të pranuar a	Aprov. i vend. të AK-së	Ri vlerësim	Ri tenderim	Tërheqje e Anke.	Flakje e Ankesës	Urdhër për Zbatim të vend. PSH-së	Ndryshim në Dosje të Tenderit	Përmirësim- Zgajtje e afatit për ofertim
16	Univ Hasan Prishtina	28	5	11	4	1	2	4	1	
17	Ministria për kthim dhe komunitete	4		3			1			
18	Zyra e Presidentit	3	1	1			1			
19	Policia e Kosovës	20	6	11		1	2			
20	KEK	98	38	50	2	1	3	1	3	
21	AQP	12	7	2		2		1		
22	QKUK	22	9	9	1		1		2	
23	SHSKUK	44	15	21		2	2		2	2
24	KK Skënderaj	5	3	1					1	
25	KK Prishtinë	73	17	44	2	1	3	1	5	
26	KK Prizren	93	18	53	6		5	3	7	1
27	KK Mitrovicë	1			1					
28	KK Gjakovë	37	3	27	1		3		2	1
29	KK Drenas	10	2	7		1				
30	KK Lipjan	25	5	15	2	1	1		1	

Nr	Autoriteti Kontartkues	Ankesa të pranuar a	Aprov. i vend. të AK-së	Ri vlerësim	Ri tenderim	Tërheqje e Anke.	Flakje e Ankesës	Urdhër për Zbatim të vend. PSH-së	Ndryshim në Dosje të Tenderit	Përmirësim- Zgajtje e afatit për ofertim
31	KK Novobërdë	1								1
32	KK Kaçanik	10	1	9						
33	KK Shtime	4	1	2	1					
34	KK Viti	7	2	1	1		1		2	
35	KK Dragash	9	3	5	1					
36	KK Graçanicë	5	3	2						
37	KK Ferizaj	35	7	21	2		4		1	
38	KK Obiliq	9	2	5			1	1		
39	KK Deçan	9	3	5			1			
40	KK Klinë	25	3	18		1	3			
41	KK Fushë Kosovë	5	1	4						
42	KK Vushtrri	18	7	11						
43	KK Kamenicë	5	4	1						
44	KK Leposaviq	4	2				2		1	
45	KK Mitrovica e Veriut	3		1	2					

Nr	Autoriteti Kontartkues	Ankesa të pranuar a	Aprov. i vend. të AK-së	Ri vlerësim	Ri tenderim	Tërheqje e Anke.	Flakje e Ankesës	Urdhër për Zbatim të vend. PSH-së	Ndryshim në Dosje të Tenderit	Përmirësim- Zgajtje e afatit për ofertim
46	KK Podujevë	7	2	1		1	3			
47	KK Malishevë	20	5	6	3	3	2	1		
48	KK Gjilan	24	5	18	1					
49	KK Shtërpcë	5	3	2						
50	KK Istog	9	2	5			2			
51	KK Suharekë	33	10	22					1	
52	KK Junik	5	1	2				2		
53	KK Pejë	16	2	14						
54	KK Rahovec	10	4	5	1					
55	KK Mamushë	5	1	2	1		1			
56	KK Partesh	1			1					
57	KK Hani i Elezit	3	2				1			
58	KK Klllokot	1		1						
59	Dogana e Kosovës	5	2	1		1	1			
60	QKTGJ	1							1	

Nr	Autoriteti Kontartkues	Ankesa të pranuar a	Aprov. i vend. të AK-së	Ri vlerësim	Ri tenderim	Tërheqje e Anke.	Flakje e Ankesës	Urdhër për Zbatim të vend. PSH-së	Ndryshim në Dosje të Tenderit	Përmirësim-Zgajtje e afatit për ofertim
61	KUR Gjakova	3	2	1						
62	Posta e Kosovës	1	1							
63	KRM Pastrimi	11	3	2			3		2	1
64	AKP	3		2	1					
65	Trepça	6	4	1		1				
66	Keshilli Prokurorial	6	2	1	1		1			1
67	AKSP	5	3	1					1	
68	Qendra Multifunksionale ShA	1	1							
69	Shërbimi Korrektues I Kosovës	9	5	4						
70	Gjykata Kushtetuese	2	1		1					
71	Këshilli Gjyqësor I Kosovës	9	2	5	1	1				
72	Iber Lepenci sha	5		2	1		1		1	
73	KQZ	1	1							
74	ATK	1	1							
75	ASHNA	2	1	1						

Nr	Autoriteti Kontartkues	Ankesa të pranuar a	Aprov. i vend. të AK-së	Ri vlerësim	Ri tenderim	Tërheqje e Anke.	Flakje e Ankesës	Urdhër për Zbatim të vend. PSH-së	Ndryshim në Dosje të Tenderit	Përmirësim- Zgajtje e afatit për ofertim
76	Agjencia e Menagjimit Emergjent	6	3	1			1	1		
77	KMDK	12	3	7					2	
78	KPMM	15	8	4					2	1
79	KOSTT sh.a.	13	5	7					1	
80	AKKVP	4	1	1	1		1			
81	Universiteti i Gjakoves	10	1	7			2			
82	Zyra Kombëtare e Auditimit	5	2	2		1				
83	Univ.Kadri Zeka	5	2	2					1	
84	Spitali Regjional Prizren	5	2	2			1			
85	Spitali Ferizaj	4	1	1	2					
86	Univ. Haxhi Zeka-Pejë	7	3	4						
87	KRU Hidromorav	2		2						
88	Spitali Gjilan	6	2	3			1			
89	Ekoregjioni sha	2	1	1						
90	KUR Prishtina	15	6	7	1	1				

Nr	Autoriteti Kontartkues	Ankesa të pranuar a	Aprov. i vend. të AK-së	Ri vlerësim	Ri tenderim	Tërheqje e Anke.	Flakje e Ankesës	Urdhër për Zbatim të vend. PSH-së	Ndryshim në Dosje të Tenderit	Përmirësim- Zgajtje e afatit për ofertim
91	KUR Mitrovica	2	1	1						
92	Universiteti Ukshin Hoti Prizren	3	1	1	1					
93	Agjencia Veterines dhe Ushqimit	4			3	1				
94	AMKMK	2		1		1				
95	KRU Hidrodrini	1	1							
96	KRM Çabрати	1		1						
97	Qendra e Studenteve	8	1	4	2				1	
98	KRM Gjakova	1		1						
99	NPL Pallati I Rinisë	3		3						
100	IMPK	6		5	1					
101	KRM Ambienti	1	1							
102	Trafiku Urban	2	1		1					
103	CDI	1	1							
104	Sport Marketing sha	1		1						
105	Hortikultura sha	1	1							

Nr	Autoriteti Kontartkues	Ankesa të pranuar a	Aprov. i vend. të AK-së	Ri vlerësim	Ri tenderim	Tërheqje e Anke.	Flakje e Ankesës	Urdhër për Zbatim të vend. PSH-së	Ndryshim në Dosje të Tenderit	Përmirësim- Zgajtje e afatit për ofertim
106	Spitali Pejë	3	1	1			1			
107	ASHAK	4		1	1		1			1
108	Termokos sh.a.	14	3	11						
109	NPL Pastrimi	1	1							
110	KRM Uniteti sh.a.	3		2				1		
111	QKMF Prishtina	1	1							
112	IKSHP	2	1	1						
113	Spitali Gjakovë	3		2				1		
114	Trainko sha	1	1							
115	KEDS	1				1				
116	NPL Prishtina Parking	1							1	
117	Drejtoria për bujqësi dhe zhvillim rural KK Prizren	2					2			
118	NPB	7	3	4						
	Gjithsejtë	1184	339	605	63	25	80	17	45	10

GJOBAT

- Gjatë vitit 2020, OSHP-ja ka shqiptuar tre gjoba për mosrespektim të vendimeve të paneleve shqyrtuese dhe atë një ndaj AK-KK Mamushë në vlerë prej 5,000.00 €, një ndaj AK-MAP në vlerë prej 5,000.00 € dhe një ndaj MSH në vlerë prej 10,000.00€.

Tabela e gjobave-2020

Autoriteti kontraktues	Vendimi i PSH-së	Data e vendimit	Shuma e gjobës
KK Mamushë	57/20	11.03.2020	5,000.00 €
MAP	122,127/20	18.03.2020	5,000.00 €
MSH	442/20	04.09.2020	10,0000.00 €
Gjithsejtë			20,000.00 €

• **Të hyrat të inkasuara nga gjobat e shqiptuara autoritetëve kontraktuese**

- Gjatë vitit 2020, OSHP përmes procedurës përmbartuese ka inkasuar dy gjoba të shqiptuara ndaj autoritetëve kontraktuese për mos respektim të vendimeve të OSHP-së dhe atë një ndaj Universiteti “Hasan Prishtina” në vlerë prej 15,000.00 € dhe një ndaj AK MAP në vlerë prej 5,000.00 € . Këto të hyra shkojnë në departamentin e Thesarit pasi që është realizuar borxhi dhe shpenzimet e përmbartimit.

- Poashtu, OSHP është duke zhvilluar procedurën e përmbartimit edhe ndaj gjashtë (6) institucionëve tjera për gjobat e shqiptuara gjatë viteve paraprake për mos respektim të vendimeve të paneleve shqyrtuese të OSHP-së.

• **Ndarja e ankesave sipas muajve kalendarik**

- Gjatë vitit 2020, numri i ankesave sipas muajve kalendarik, ka pasuar ndryshime në disa muaj. Volumi më i madh i ankesave i përket muajve Tetor, Nëntor dhe Dhjetor. Në formë statistikore, në tabelën e më poshtme janë paraqitur numri i ankesave të pranuar sipas muajve gjatë vitit 2020.

• **Urdhëresat e Shqiptuara ndaj Autoriteteve Kontraktuese**

- Me LPP, përcaktohet qartë se vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit, pas shqyrtimit të ankesave, janë përfundimtare, mirëpo disa Autoritete Kontraktuese i kanë neglizhuar procedurat e prokurimit publik, duke mos i respektuar vendimet e paneleve shqyrtuese për rivlerësimin e ofertave apo anulimin e aktiviteteve të prokurimit. Veprimet e këtilla të Autoriteteve Kontraktuese përbëjnë shkelje të LPP-së, e njëkohësisht kanë edhe efekt negativ në shfrytëzimin racional të fondeve publike.
- Për shkak të mos respektimit të vendimeve të mëparshme të Paneleve Shqyrtuese, OSHP-ja, ka shqiptuar gjithsej **20** urdhëresa ndaj Autoriteteve të ndryshme kontraktuese.

- Në tabelën e më poshtme janë paraqitur të dhënat lidhur me shqiptimin e urdhëresave ndaj Autoriteteve Kontraktuese, për mosrespektim të vendimeve të Paneleve Shqyrtuese.

Nr	Autoriteti Kontraktues	Urdheresat e shqiptuara
1	KK Prizren	3
2	AME	1
3	AQP	1
4	KEK	1
5	Spitali Gjakove	1
6	KK Junik	2
7	KK Prishtine	1
8	KRM Uniteti sh.a.	1
9	KK Obiliq	1
10	Universiteti Hasan Prishtina	4
11	KK Malisheve	1
	Gjithsejte	17

- Diskualifikimi i Operatorëve Ekonomikë**
- OSHP-ja është kompetente për diskualifikim të operatorëve ekonomik konform nenit 99.2 të LPP-së. Në vijim është tabela me të dhënat, kërkesat e autoriteteve kontraktues dhe vendimet e OSHP-së në lidhje me këto kërkesa.

Tabela e kërkesave për diskualifikimin e Operatorëve Ekonomik dhe vendimet e OSHP

DISKUALIFIKIMI I OPERATOREVE EKONOMIK

OSHP-ja është kompetente për diskualifikim të operatorëve ekonomik konformë nenit 99.2 të LPP-së. në vijim është tabela me të dhënat, kërkesat e autoriteteve kontraktuese dhe vendimet e OSHP-së në lidhje me këto kërkesa


Nr	AK	Operatori Ekonomik	Titulli i Aktivitetit	Vendimi i OSHP-së
<u>54/20</u>	<u>Policia e Kosoves</u>	<u>OE-AutoKosova shpk</u>	<u>Furnizim me vegla pune dhe paisje te punes per servisimin e flotes operative si dhe furnizim me paisje per automjete RT 1-2</u>	refuzohet kerkesa e AK-se per dikualifikim
<u>86/20</u>	<u>KK Prishtine</u>	<u>Vlera shpk Shtime</u>	<u>DDD I institucioneve arsimore</u>	refuzohet kerkesa e AK-se per dikualifikim
<u>126/20</u>	<u>Policia e Kosoves</u>	<u>Ballkan Petrol</u>	<u>Furnizim me vajra</u>	refuzohet kerkesa e AK-se per dikualifikim
<u>144/20</u>	<u>KK Skenderaj</u>	<u>Qendrim Gashi B I</u>	<u>Renovimi I ambulances se mjekesise familjare AMF Polac</u>	refuzohet kerkesa e AK-se per dikualifikim
<u>145/20</u>	<u>KK Skenderaj</u>	<u>Tosi-V shpk</u>	<u>Renovimi dhe vendosja e dyerve levizese elektrike ne QKMF Komuna e Skenderajt</u>	refuzohet kerkesa e AK-se per dikualifikim
